



Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iașit, në Rumani në kuadër të Programit Erasmus+

Mobiliteti dhe kohëzgjatja:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iașit, Rumani.

Kush mund të aplikojë?

- Studentët Bachelor të UMT-së që studiojnë në vitin e dytë dhe të tretë akademik;
- Studentët Master të UMT-së që studiojnë në vitin e parë dhe të dytë akademik;

Nga:

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
- Fakulteti i Ekonomisë

Gjuha e Mësimdhënies:

Gjuha e mësimdhënies do të zhvillohet në anglisht.

Bursa përfshijë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EURO në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmusplus/tools/distance_en.htm

Travel distance	Amount per participant
Between 10 and 99 Km	20 Euros
Between 100 and 499 km	180 Euros
Between 500 and 1999 km	275 Euros
Between 2000 and 2999 km	360 Euros
Between 3000 and 3999 km	530 Euros
Between 4000 and 7999 km	820 Euros
8000 km or more	1.500 Euros



Dokumentet për aplikim

1. Kopje e pasaportës;
2. Lista e notave;
3. Vërtetim Studenti;
4. Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2;
5. Dokumenti Learning Agreement;

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iașit, në Rumani lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2023/2024 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshkruhen në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

<https://www.uaic.ro/en/international/erasmus-programme-with-partner-countries/forms/>

Për më shumë informacion mbi programin e studimit të ofruar nga Universiteti pritës:

<https://www.uaic.ro/en/international/international-students/course-catalog-for-incoming-students/>

Afati për aplikime: 13 Nëntor, 2023

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë fizikisht dhe me e-mail në iro-projects@umt.edu.al.

UMT ju uron suksese në aplikim tuaj!